



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

### V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATES TË OJQ-SË PËRFITUESE PËR AKTIVITETET E MUAJIT QERSHOR

#### Neni 1

Me këtë Vendim, **Islam Sylejmani**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontrates të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së "Inovative Community Development Center " e lidhur për realizimin e projektit "Aktivitetet e Muajit Qershor" për vitin 2023.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrates të OJQ-së si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ "Inovative Community Development Center"

#### Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontrates të lidhur mes Komunës dhe OJQ-së të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

#### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Islam Sylejmani dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 453/01-25722  
Lipjan, më 18.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 dhe sipas kërkesës së Drejtoratit Për Ekonomi dhe Zhvillim 1Nr-300/01-24645 e datës 15.05.2023, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR EMËRIMIN E EKIPIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR CERTIFIKIM NË PROGRAMIN  
BFC SEE PROJEKT

**Neni 1**

Me këtë Vendim Emërohet Ekipi për Certifikim në Komunën e Lipjanit në programin BFC SEE në përbërje si vijon:

**Neni 2**

- 1.Valon Pacolli – Koordinator i Ekipit,
- 2.Linda Shahini-Përdoruese e Llogarisë për Qasje në softuerin BFC SEE
- 3.Safete Amerllahu –Drejtoreshë në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër ,anëtare,
- 4.Burim Gashi – Drejtoratin për Administratë,anëtar,
- 5.Jalldyze Gashi- Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ,anëtare,
- 6.Shehide Sopa- Ibrahim- Drejtorati Për Ekonomi dhe Zhvillim-anëtare,
- 7.Shahadije Ibrahim- Drejtorati Për Buxhet dhe Financa,anëtare,
- 8.Ferdian Shala – Sektori për Mardhënie me Publikun, anëtar
- 9.Bajrush Limani- zyrtar IT-së- anëtar,
- 10.Merita Zeqiri –Drejtorati për Infrastruktur ,anëtare
11. Qëndresa Jashanica- Dërmaku, Sektori për Mardhënie me Publikun, anëtare
- 12.Teuta Berisha – Drejtorati për Arsim ,anëtare

**Neni 3**

Ekipi i komunës për certifikim do të jetë përgjegjës për zbatimin e procesit të certifikimit në programin e BFC SEE.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Koordinatori dhe anëtarët e tjerë të Ekipit.

Me hyrje në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me 1Nr.300/01-24645/2 i datës 16.05.2023

1Nr.300/01-24645/3  
Lipjan, më 29.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 03.04.2023 si dhe shpalljes të vazhdimit të afatit për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 24.04.2023, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E  
KËRKESAVE TË FERMERËVE**

**Neni 1  
Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 03.04.2023 për ndarjen e shpërndarseve plehu mineral, spërkatëse 400L dhe freza për traktor për vitin 2023, (në vazhdim të tekstit Komisioni), si dhe shpalljes të vazhdimit të afatit për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 24.04.2023 në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastruktur, Kryesuese
2. Azem Arifi, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
3. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Infrastruktur, anëtare

**Neni 2  
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për shpërndarse plehu mineral, spërkatëse 400L dhe freza për traktor për vitin 2023 si dhe shpalljes të vazhdimit të afatit për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 24.04.2023, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 03.04.2023 si dhe shpalljes të vazhdimit të afatit për aplikim Nr.12-320/01-16766 e datës 24.04.2023 dhe legjislacionit në fuqi.

- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.
- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr. 020/04-23859

Lipjan, 10.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-17118 të datës 05.04.2023, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Flaka Bikliqi nga OJQ-të, anëtare
5. Shkurta Kozhani, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertes, anëtare
6. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezerv

**Neni 2**

**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në projektet për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest 2023" në Komunën e Lipjanit konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-17118 të datës 05.04.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-26709  
Lipjan, më 25.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

## VENDIM

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

#### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,300.00€**, (gjashtë mijë e treqind euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-22576 të datës 03.05.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 30 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin prill të vitit 2023 me nga 210 euro për secilin rast  $30 \times 210 = 6,300.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

#### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB Bank.

#### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-22576  
Lipjan, më 04.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.27 e datës 03 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

#### VENDIM

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT MBI PËRCAKTIMIN E SHUMËS SË SHPENZIMEVE TË REPREZENTACIONIT PËR POZICIONET E PUNËS 1NR.400/01-2630 I DATËS 13.01.2023

I. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet pika I e Vendimit mbi përcaktimin e shumës së shpenzimeve të reprezentacionit për pozicionet e punës 1Nr.400/01-2630 i datës 13.01.2023, për vitin 2023, si vijon:

Pika I – në pjesën tabelare pas pozicionit të punës Zëdhënës i Komunës së Lipjanit në numrin rendor 8 shtohet pozicioni i ri në numrin rendor 9, **Shef i Zyrës Lokale për Komunitete**, 1 kryers, shuma mujore 20 € (njëzet euro).

II.Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohet Zyra Lokale për komunitete, Drejtorati për Administratë dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa .

1Nr.400-01-2630/2  
Lipjan, më 11.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin “Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024” Nr.5-453/01-43790 të datës 15.08.2022, Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-453/01-45453 të datës 22.08.2022, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

#### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 1NR.453/01-45453 I DATËS 23.08.2022 PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTIN “PLANI I VEPRIMIT RINOR LOKAL 2022-2024”**

I. Me këtë Vendim ndyshohet dhe plotësohet neni 2 i Vendimit 1Nr.453/01-45453 i datës 23.08.2022 për ndarjen e mjeteve financiare për projektin “Plani i Veprimit Rinor Lokal 2022-2024 dhe riformulohet si vijon:

“Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2022, 2023 dhe 2024 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport. Ekzekutimi i pagesës do të paguhet në tri kiste të barabarta për secilin vit përkatës përkatësisht një kist i pagesës do të jetë 12,000.00 € (dymbëdhjetë mijë euro) nga shuma totale për pagesë 36,000.00 € (tridhjetë e gjashtë mijë euro)”.

II.Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-45453/2  
Lipjan, më 30.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2023, duke u bazuar dhe në Raportin e Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve 1Nr.404/01-25114 të datës 16.05.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR SHITJEN E ASETEVE

### Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Raportit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve të datës 16.05.2023, do të bëhet shitja e aseteve - inventarit jashtë përdorimit dhe i demoluar (tavolina , karrika , ormana, shtretër dhe gjashtë vetura) , me çmimin fillestar të komplet inventarit 2,000 €, në pronësi të Komunës së Lipjanit , të cilat gjenden në kuadër të hapësirës së jashtme të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan, sipas listave të bashkëngjitura në shtojcë të këtij Vendimi.

### Neni 2

Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë listat të cilat i janë bashkëngjitur Raportit dhe Procesverbalit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale .


### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe QKMF-Lipjan.

1Nr.404/01-25114  
Lipjan, më 16.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2023, duke u bazuar dhe në Raportin e Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e asetëve 1Nr.404/01-25112 të datës 16.05.2023, Kryetari i Komunës, nxjerr

## VENDIM PËR SHITJEN E ASETEVE

### Neni 1

1.Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Raportit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e asetëve të datës 16.05.2023, do të bëhet shitja e asetëve - inventarit jashtë përdorimit, në pronësi të Komunës të cilat gjenden në objektin e vjetër të Komunës së Lipjanit në rr. Shqipëria në Lipjan nr.28.

2.Asetet do të shiten sipas çmimeve fillestare si vijon:

Nr.	Lloji i asetit	Çmimi fillestar	Vërejtje
1.	Kalldaja me pjesët përcjellëse, rezervar dhe radiator alumini dhe hekuri të madhësive të ndryshme	3000 €	Shtojcë- lista e asetëve
2.	Inventari (tavolina, karrika, ormana)	2,057.40 € për komplet inventarin	Shtojcë- lista e asetëve
3.	Ormana metalik të hapur , të mbyllur dhe sirtarët	20,00 € për copë	Shtojcë- lista e asetëve
4.	Paisje teknologjike (monitor,shtëpizë, printer,UPS, telefon, fotokopjues-printer etj )	0.20 € për kg	Shtojcë- lista e asetëve
5.	Paisjet –asetet - hekur	0.20 € për kg	Shtojcë- lista e asetëve

Neni 2

Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë listat të cilat i janë bashkëngjitur Raportit dhe Procesverbalit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Administratë .

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Administratë.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për shitjen e aseteve 1Nr.404/01-24438 I datës 12.05.2023.

1Nr.404/01-25112

Lipjan, më 16.05.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtorit të QKMF-së 1-404/01-16336 të datës 31.03.2023, Procesverbalin e Komisionit për vlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë komunale Nr.3-114/05-15742 të datës 28.03.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR SHITJEN E ASETEVE-VETURAVE ZYRTARE JASHTË PËRDORIMIT

### Neni 1

Me këtë Vendim, në procedurë të ankandit publik konform Kërkesës së Drejtorit të QKMF-së 1-404/01-16336 të datës 31.03.2023 dhe Procesverbalit e Komisionit për vlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë komunale Nr.3-114/05-15742 të datës 28.03.2023 , do të bëhet **shitja** e aseteve – veturave zyrtare jashtë përdorimit, me shënimet si në tabelën vijuese:

Nr :	Emërtimi	Numri i Targave	Sasia	Id. E artikullit të pasurisë	Viti i Prodhit	Vlera Fillestare (€)	Vlera e mbetur pas amortizimit në SIMFK	Çmimi i vlerësuar për shitje	Vërejtje	Dogana
1	VETUR FORD TRASIT-T:01-820	01-820-DG	1	2014 05492	2005	3,500.00	0.00 €	<b>0.20 € (euro) të një kg. hekur</b>	E çregjistruar në vitin 2018	Donacion
2	VETUR VW TRANSPORTER-T:01-8	01-651-DF	1	2014 054094	2003	13,500.00	0.00 €		E çregjistruar në vitin 2016	Donacion
3	VETUR KIA PREGIO-T:01-592:CL	01-592:CL	1	2014 05498	2001	4,500.00	0.00 €			Donacion
4	VETUR MERCEDES-BENZ 314-T:0	01-297-DH	1	2014 05499	1999	4,000.00	0.00 €			Donacion
5	KOMBI RENAULT MASTER 2:2 DIZEL	01-706-HI	1	2011 08917	2001	8,5000.00	0.00€			Donacion
6	VETUR KIA PREGIO 285.KS-359	285-KS-359	1	2006 10715	2001	4,200.00	0.00€		E demoluar	Donacion

## Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale , QKMF-Lipjan dhe Drejtorati për Prokurim.

## Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe QKMF-Lipjan.

INr.404/01-16336  
Lipjan, më 03.04.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF – NR.02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 i datës 24.12.2023, duke u bazuar dhe në Raportin e Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve 1Nr.404/01-24438 të datës 12.05.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

## VENDIM PËR SHITJEN E ASETEVE

### Neni 1

Me këtë Vendim në procedurë të ankandit publik sipas Raportit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve të datës 12.05.2023, do të bëhet shitja e aseteve - inventarit jashtë përdorimit, në pronësi të Komunës të cilat gjenden në objektin e vjetër të Komunës së Lipjanit në rr. Shqipëria në Lipjan nr.28, sipas listave të bashkëngjitura në shtojcë të këtij Vendimi.

### Neni 2

Pjesë përbërëse të këtij Vendimi janë listat të cilat i janë bashkëngjitur Raportit dhe Procesverbalit të Komisionit për regjistrimin dhe vlerësimin e aseteve

### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Administratë .

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Administratë.

1Nr.404/01-24438  
Lipjan, më 12.05.2023

KRYETARI I KOMUNES

për Imri Ahmeti

